



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA - GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:263390

Datë: 23.06.2022

Numri i dokumentit: 03165682

C.nr. 1003/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm– Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, në çështjen juridike të paditëses KEP, ndaj të paditurave B... K.... dhe S... S... që të dy nga Gj... me objekt kontesti për pagimin e borxhit nga marrëveshja mbi kredinë, jashtë seancës gjyqësore, më datë 23.06.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditëses KEP...., ndaj të paditurave B... K... dhe S... S... që të dy nga Gjilani.

A r s y e t i m

Paditësja KEP, më datë 13.11.2019, ka paraqitur padi ndaj të padituravedhe që të dyja nga Gjilani.

Gjykata ka caktuar seancën përgaditore për datën 23.06.2022, në të cilën seancë nuk ka prezentuar paditësja, ku gjykata ka konstatuar se ftesën për seancë e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datë 07.06.2022 poashtu kanë munguar edhe të paditurit ku gjykata ka konstatuar se ftesën për seancë e kanë pranuar me dt.08.06.2022 e gjykatës nuk i kanë dorëzuar ndonjë parashtrësë as paditësja e as të paditurit me të cilën do të arsyetonin mungesën e tyre dhe do të kërkonin shtyerjen e kësaj seance.

Gjykata duke u bazuar në nenin 409.1 të LPK –së, ku shprehimisht përcaktohet „*Në qoftë se në seancën përgaditore nuk vjen pala paditëse, edhe pse e thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që séance të mbahet*” , andaj Gjykata e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses .

Nga të cekurat më lart, në bazë të nenit 142 par.1dhe nenit 409 par.1 të LPK-ës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata Themelore Në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1003/2019, më datë 23.06.2022

Gj y q t a r j a
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pa knaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.